



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

KOLEGJI "PJETER BUDI" - PRISTINË

RREGULLORE PËR IMPLEMENTIMIN E SISTEMIT EVROPIAN TE TRANSFERIT TE KREDIVE (ECTS)

Prishtine, 2020



Në bazë të nenit 64 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi, Senati Akademik i Kolegjit me datë 29.12.2020, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR IMPLEMENTIMIN E SISTEMIT EVROPIAN TË
TRANSFERIT TË KREDIVE (ECTS)**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen bazat unike për organizimin dhe realizimin e programeve studimore dhe regjimin e studimit sipas sistemit evropian të transferimit të kredive (ECTS) në Kolegjin "Pjetër Budi"- Prishtinë, në tekstin e mëposhtëm Kolegji "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Qëllimi i ECTS

Neni 2

2.1. Sistemi evropian i transferimit të kredive paraqet një sistem të njohjes akademike të studimeve bazuar në: informata për programet studimore dhe arritjet e studentit, besimi i ndërsjellët në mes të njërive të ndryshme të Kolegjit, marrëveshje të ndërsjella të Universiteteve, Kolegjeve, Instituteve partnere në vend dhe jashtë, dhe përdorimi i kredive (pikëve) si masë për ngarkesën e studentit.

2.2. **Me sistemin e transferimit të kredive realizohet:**

- Mobilitet i shtuar i studentit në nivel institucional, nacional dhe ndërkombëtar;
 - Analizë precize e vëllimit të punës dhe matjes së ngarkesës së studentit në procesin e studimit;
 - Zhvillim dhe funksionim i mekanizmit për përcjellje të vazhdueshme të përparimit të studentit sipas rezultateve nga mësimi;
 - Objektivet në vlerësimin dhe pranimin e rezultateve të studimit;
 - Realizim i kompatibilitetit të programeve studimore në nivel institucional, nacional dhe ndërkombëtar;
 - Krijim i mobilitetit ndërkombëtar të studentit dhe realizim i kompatibilitetit të programeve studimore në nivel internacional, sipas principeve të Sistemit evropian të bartjes së kredive - ECTS (European Credit Transfer System);
-



- Bartje e pandërprerë e arritjeve të studentit nga një institucion në një tjetër;
- Individualizim i rritur i rrjedhës së studimit dhe
- Krijim i bazave për realizimin e konceptit të mësimi permanent.

Zbatimi i sistemit të transferimit të kredive

Neni 3

Sistemi i transferimit të kredive zbatohet në realizimin e programeve studimore dhe programeve të lëndëve për:

- Ciklin e parë të studimeve universitare - Bachelor;
- Ciklin e dytë të studimeve universitare - Master.

Struktura e programeve studimore dhe ECTS

Neni 4

4.1 Një program studimor nga cikli i parë i studimeve (të rregullta) përbëhet nga lëndët e obligueshme dhe zgjedhore, ndërsa sipas nevojave të programit studimor mund të parashihen edhe mënyra tjera për nxënien e njohurive nga ana e studentëve për të cilat ndahet një numër adekuat i kredive, siç janë: punimi i projekteve të pavarura, projekti përfundimtar - punimi i diplomës, punë praktike etj.

4.2 Pjesëmarrja e lëndëve të obligueshme nuk mund të jetë më e madhe se 60% nga numri i përgjithshëm i lëndëve në programin studimor.

Si lëndë zgjedhore mund të zgjedhën:

- Lëndë nga lista e lëndëve të ofruara në kuadër të programit studimor dhe
- Lëndë relevante nga programet tjera studimore në kuadër të Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë.
- Lëndë relevante nga programet studimore të Institucioneve të Arsimit të lartë në vend dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve me Kolegjin " Pjetër Budi" - Prishtinë.

4.3. Lëndëve zgjedhore i ndahen kredi (pikë) sipas kriterëve të njëjta si tek lëndët e obligueshme.

4.4. Përkundër lëndëve të obligueshme dhe zgjedhore të parapara në programin studimor, studentët mund të marrin njohuri dhe kredi edhe nga lëndët fakultative. Lëndët fakultative janë lëndë të cilat studentët munden, por nuk janë të obliguar ti zgjedhin. Nëse i kryejnë të gjitha aktivitetet e kërkuara të parapara në programin e lëndës fakultative, studentët fitojnë numër adekuat të kredive, jashtë programit studimor, ndërsa të njëjtat evidentohen në Shtojcën e diplomës.

Termi kredi (pikë) në ECTS



Neni 5

Kredia paraqet një vlerë relative numerike, e cila definohet në programet e lëndëve, me të cilën përshkruhet kuantiteti i punës së studentit në raport me sasinë e përgjithshëm të punës, të nevojshme për kryerjen e një viti akademik në njësinë e Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Neni 6

- 6.1. Numri i kredive (pikëve) që studenti duhet ti fitoj që të fitoj përgatitje të caktuar profesionale (diplomë) është 60 kredi (pikë) për një vit akademik.
- 6.2. Një kredi (pikë) i përgjigjet 25 orëve punë, që nënkupton se ngarkimi i përgjithshëm vjetor i studentëve duhet të jetë prej 1200 deri 1500 orë.
- 6.3. Sipas kësaj, për studimet trevjeçare nga cikli i parë gjithsej janë të nevojshme 180 - 240 kredi,

Neni 7

Numri kredive (pikëve) për secilën lëndë në secilin program studimor në kuadër të Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë, është 6 kredi.

Mënyra e ndarjes së kredive

Neni 8

- 8.1. Numri i kredive (pikëve) për programet e lëndëve përcaktohet në bazë të ligjëratave, kollokuiumeve, respektivisht provimeve përfundimtare, konsultimeve të kryera, ushtrimeve të realizuara, punës praktike të realizuar, të punimeve seminarike, punës në terren, punës së pavarur/në shtëpi, mësimit në bibliotekë, projekteve të përpunuara apo realizuara, punimit të specializuar, punimit të magjistraturës, punimit të doktoratës etj.
- 8.2. Për sqarimin e plotë të mënyrës së ndarjes së kredive për një **program të lëndës**, në tabelën në vijim është dhënë një shembull për një lëndë një semestrale e cila, përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, ka paraparë edhe aktivitete tjera.



KOLEGJI - COLLEGE

PJETËR BUDI

Prishtinë - Prishtina

Kategoria e ngarkesës javore të studentit	Orë në javë	Numri i javëve	Numri i përgjithshëm i orëve për lëndë në kohëzgjatje prej 15 javësh (një semestër) (2 x 3)
1	2	3	4
Ligjërata	3	13	39
Ushtrime	2	13	26
Ligjërata në terren	5	1	5
Punime seminarike	8	2	16
Mësim individual	4	15	60
Kalimi i kolokuiumeve	2	2	4
Gjithsej			150

150 (ngarkesa e përgjithshme): 25 (orë për 1 kredi) = 6 kredi, respektivisht për lindën në këtë shembull do ta ndahen 6 kredi.

Ndarja e kredive (pikëve) për lloje të ndryshme të aktiviteteve studentore jashtë programit studimor

Neni 9

9.1. Kredi (pikë) mund të ndahen edhe për lloje të ndryshme të aktiviteteve studentore: mbajtja praktikës profesionale, përpunimi apo realizimi i projekteve, pjesëmarrja në tubime shkencore etj.

9.2. Aktivitetet për të cilat do të ndahen kredi i përcakton Kolegji " Pjetër Budi" - Prishtinë , para fillimit të vitit akademik.

Këto kredi futen në Shtojcën e diplomës në pjesën e informatave shtesë për aktivitetet e realizuara.



Organet dhe trupat për realizimin e ECTS dhe mënyra e mbajtjes së evidencës

Neni 10

31.1. Për zbatimin dhe përcjelljen e dispozitave nga Rregullorja për Sistemin Evropian të Transferit të Kredive dhe kalimin nga një program studimor në një tjetër brenda Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë, themelohet Zyra Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurimin e Cilesise.

31.2. Përgjegjës për udhëheqjen dhe menaxhimin e Zyres për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurimin e Cilesise në nivel të Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë është Prorektori për Mësim, Huluntim dhe Zhvillim Akademik.

II. ZYRA PËR ZHVILLIM AKADEMIK, ECTS, SIGURIM TË CILËSISË DHE HULUMTIM

Neni 11

Zyrtarët e Zyrës për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurim të Cilësisë dhe Huluntim në kuadër të Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë kryen këto detyra.

- I përcjell obligimet e Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë në realizimin e principeve dhe mekanizmave të ECTS;
 - E promovon ECTS në Kolegjin " Pjetër Budi" - Prishtinë dhe jashtë tij;
 - Jep përkrahje në realizimin praktik të ECTS, si dhe përkrahje për koordinatorët e njësive të brendshme organizative;
 - I informon studentët për ECTS;
 - I koordinon proceset e Kolegjit " Pjetër Budi" - Prishtinë rreth: përgatitjes, prodhimit dhe shpërndarjes së paketave informative;
-



KOLEGJI - COLLEGE

PJETËR BUDI

Prishtinë - Prishtina

- Siguron realizimin e kontakteve nacionale dhe ndërkombëtare;
- Informon për mundësitë për mobilitet të studentëve;
- Informon organet e Kolegjit " Pjetër Budi" – Prishtinë për aktivitetet lidhur me implementimin e ECTS;
- Përgatit raport vjetor për realizimin e ECTS-së.
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me Ligjin, Statutin e Kolegjit dhe Rregulloret tjera të Kolegjit.

III. MOBILITETI I STUDENTËVE

Kalimi nga një program studimor në një tjetër në kuadër të Kolegjit " Pjetër Budi" – Prishtinë

Neni 12

40.1. Studenti mund të kaloj nga një program studimor në një tjetër në kuadër të Kolegjit " Pjetër Budi" – Prishtinë.

40.2. Kriteret për kalim nga pika paraprake i përcakton Kolegji " Pjetër Budi" – Prishtinë, varësisht nga kompatibiliteti i programeve studimore, e njëkohësisht arrihet marrëveshje edhe me studentin..

Kalimi nga një institucion i Arsimit të Lartë në Kosovë në Kolegjin " Pjetër Budi" – Prishtinë

Neni 13

41.1. Kriteret për kalim i përcakton Kolegji " Pjetër Budi" – Prishtinë, varësisht nga kompatibiliteti i programeve të tyre studimore.

41.2. Procedura dhe rregullat e transferimit të studentëve përcaktohen me rregullore të posaçme.

Mobiliteti ndërkombëtar

Neni 14

42.1. Kolegji " Pjetër Budi" – Prishtinë, në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje mundëson transferimin e kredive ECTS-së, nga një Universitet apo Institucion tjetër i Arsimit të Lartë jashtë Kosove në Kolegjin " Pjetër Budi" – Prishtinë.



IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Kjo rregullore shfuqizon rregulloren e vjeter për implementimin e sistemit evropian te transferit te kredive (ects).

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj, nga organet e Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

 **Rektori i Kolegjit**
Prof. Ass. Dr. Artan Haziri